

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5401
E martë, 13 shkurt 2018
çmimi 0.40 €

Lumezi kërkon nga
prokurorët t'u japin prioritet
lëndëve të korrupsionit

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**A DO TË SHFAQIM
EMANCIPIM
INSTITUCIONAL DHE
KULTUROR PËR
REALIZIMIN E KOMPLEKSIT
QEVERTAR, MUZEUT
DHE OBELISKUT? F.12**



Shkruan: Arianit BYTYÇI, arkitekt

**BERISHA: FSK-ja E GATSHME
PËR T'U TRANSFORMUAR
NË FORCA TË ARMATOSURA
TË KOSOVËS F.6**

**PETERLE KËRKON VAZHDIMIN
E REFORMËS ELEKTORALE**

EKONOMI

**ZEKA: VENDIMET E MARRA
PËR DHJETË VJET ISHIN MË
PAK PËRFITUESE PËR
PRODHUESIT F.9**

**NËNSHKRUHEN KONTRATAT
E OPERATORËVE PËR
NDËRTIMIN E AUTOSTRADËS
PRISHTINË - GJILAN F.8**

KULTURË

**KINEMAJA 'JUSUF GËRVALLA'
KËTË JAVË SHFAQ FILMAT
VENDORË F.13**

SPORT

**KOSOVA FESTON PAVARËSINË
EDHE ME SPORT F.14**

**RIKTHEHET LIGA E
KAMPIONËVE F.14**



FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI

FAQE 4-5

Vizita e kryeministrit malazez i kontribuon zgjidhjes së demarkacionit

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka vlerësuar se ardhja e kryeministrit të Malit të Zi, Dushko Markoviq, për vizitë në Kosovë, mund t'i kontribuojë zgjidhjes së çështjes së demarkacionit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se këto ditë edhe në

koalicionin qeverisës ka pasur përpjekje që të tejkalohet ngërçi sa i përket çështjes së demarkacionit. Maliqi ka thënë se ka pasur kontakte edhe me Podgoricën që të gjendet një solucion që Qeverinë dhe Haradinajn e nxjerrin "faqebardhë". Ai ka uruar që vizita e kryeministrit

malazez të jetë shenjë e kultivimit të marrëdhënieve më të mira fqinjësore. Sipas Maliqit, nëse Kosova këmbëngul rreth "humbjes së territorit" nuk do t'i prishë marrëdhëniet vetëm me Malin e Zi, por edhe me një pjesë të madhe të bashkësisë ndërkombëtare

PRESIDENTI I SLOVENISË, BORUT PAHOR, PO QËNDRON PËR VIZITË NË KOSOVË

Pahor: Kosova duhet t'i zbatojë obligimet ndërkombëtare

Presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor, gjatë vizitës në Kosovë ka bërë thirrje që vendi ynë t'i zbatojë marrëveshjet ndërkombëtare që ka marrë qoftë me marrëveshjet e arritura me Serbinë në Bruksel apo atë me

Malin e Zi për shënjimim e vijës kufitare. Pas takimit me presidentin Thaçi, Pahori ka thënë se zbatimimi i këtyre marrëveshjeve nga ana e Kosovës do ta bënte më të lehtë zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor ■ FAQE 3



Japonezët do t'i identifikojnë ndotësit e ajrit në Prishtinë

FAQE 7

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kryeministrit Haradinaj i bëhet pritje madhështore nga Garda Nacionale e Iowas

WASHINGTON, 12 SHKURT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë në prirjen e organizuar nga konsullata e Republikës së Kosovës në Iowa. Në këtë pritje u theksua roli i rëndësishëm i shtetit të Iowas për ngritjen e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, por edhe për mundësitë e avancimit të raporteve ndërmjet dy shteteve tona.

Para ta pranishmëve kryeministri Haradinaj ka thënë se qytetarët e Kosovës vlerësojnë lart kontributin e ShBA-së, në veçanti të shtetit të Iowas, për ndihmën dhe bashkëpunimin e deritanishëm për fuqizimin e shtetësisë së Kosovës.

I pranishëm në këtë pritje ishte edhe ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, që bashkë me përfaqësuesit e Gardës Kombëtare dhe akademike të Iowas, theksuan nevojën e bashkëpunimit me institucionet e Kosovës, në të gjitha fushat e interesit të



përbashkët, me theks në fushën e arsimit.

Konsulli i Kosovës, Xhavit Gashi, ka prezantuar të arriturat e bashkëpunimit të deritanishëm, por edhe planet për të ardhmen.

Kryeministri Haradinaj është pritur edhe nga Garda Nacionale e Iowas. "Është nder i posaçëm të jesh në mesin e ushtrisë më mike të popullit të Kosovës, ushtrisë amerikane. Gjenerali Timothy

Orr dhe Garda Nacionale në Iowa më rezervuan një pritje madhështore në bazën ushtarake të njësitit të helikopterëve luftarakë 'Black Hawk', ka thënë Haradinaj.

Presidenti Thaçi sot takohet me ambasadorin Delawie

PRISHTINË, 12 SHKURT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, sot (e martë) do ta presë në takim ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, Greg Delawie. Presidenca përmes një njoftimi për media ka bërë me dije se takimi do të ndodhë në orën 9:00. Ky takim thuhet se po ndodh në prag të shënimit të dhjetëvjetorit të pavarësisë së Kosovës.



Mbyllet aeroporti i Londrës, shkak një bombë e Luftës së Dytë Botërore

LONDËR, 12 SHKURT - Aeroporti i qytetit të Londrës është mbyllur më 11 shkurt pasi është gjetur një bombë e kohës së Luftës së Dytë Botërore afër lumit Temza. Arma është zbuluar gjatë punimeve të planifikuar afër portës së aeroportit të Londrës. "Nga policia ka nisur zbatimin e masës përjashtuese prej 214 metrash. Si rezultat, Aeroporti i qytetit të Londrës është aktualisht i mbyllur", është thënë në deklaratën e aeroportit.

Zyrtarët policorë kanë thënë se ekipet e specializuara në bashku me marinën mbretërore janë duke punuar për reduktimin e rrezikut për publikun, kurse udhëtarëve u



është thënë ta shmangin aeroportin.

Ky aeroport është shumë më i vogël në krahasim me Aeroportin Heathrow që gjendet më larg kryeqytetit. Londra

është goditur nga mijëra bomba gjatë Luftës së Dytë Botërore, nga forcat ajrore të Gjermanisë, në periudhën e shtatorit 1940 deri në maj të vitit 1941.

Macovei: Zbatimi i Vettingut, element kyç për Shqipërinë

TIRANË, 12 SHKURT - Komisioni Parlamentar i Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri ka mbajtur të hënën takimin e radhës, në të cilin ka diskutuar për reformën në drejtësi.

Kryetarja e delegacionit të Parlamentit Evropian, Monica Macovei, e cila ka drejtuar këtë takim, u shpreh se për momentin më e rëndësishme është pastrimi i drejtësisë. Ajo gjatë fjalës së saj ka theksuar se jo vetëm miratimi, por edhe zbatimi i ligjit të Vettingut është



një element kyç për progresin e Shqipërisë. "Zbatimi i Vettingut është element kyç. Ka shumë vende që kanë miratuar shumë ligje të mira, por nuk i kanë zbatuar ato. E rëndësishme që të jepni dëshmi për zbatimin e ligjeve", ka thënë Macovei.

Vuçiçi bën thirrje për marrëdhënie më të mira me Kroacinë

ZAGREB, 12 SHKURT - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiçi, nisi të hënën një vizitë dyditëshe në Kroaci. Pas takimit me presidenten kroate Kolinda Grabar Kitarović, Vuçiçi ka thënë se Serbia dhe Kroacia duhet të kenë marrëdhënie më të mira në të ardhmen. "Kur bëhet fjalë për të ardhmen, nuk kemi interesa kontradiktore në asnjë fushë. Duhet të jemi më të

përgjegjshëm dhe më seriozë", është shprehur Vuçiçi. Ai ka zhvilluar bisedime edhe me kryeministrin e Kroacisë, Andrej Plenković, ndërsa në agjendë janë edhe takimet me kryetarin e Parlamentit, Gordan Jandroković, me përfaqësues të pakicës serbe dhe me udhëheqës fetarë. Marrëdhëniet dypalëshe midis Serbisë dhe Kroacisë janë të

tensionuara prejse kjo e fundit ka shpallur pavarësinë nga ish-Jugosllavia në vitin 1991, gjë që ka çuar në konfliktin katërvjeçar me rebelët etnikë serbë, të cilët janë mbështetur ushtarakisht dhe politikisht nga Beogradi. Qindra njerëz u janë përgjigjur thirrjeve të grupeve të veteranëve të luftës për të protestuar kundër vizitës së Vuçiçit në Zagreb.



Presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor, po qëndron për vizitë në Kosovë

Pahor: Kosova duhet t'i zbatojë obligimet ndërkombëtare

Presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor, gjatë vizitës në Kosovë ka bërë thirrje që vendi ynë t'i zbatojë marrëveshjet ndërkombëtare që ka marrë qoftë me marrëveshjet e arritura me Serbinë në Bruksel apo atë me Malin e Zi për shënjimimin e vijës kufitare. Pas takimit me presidentin Thaçi, Pahor ka thënë se zbatimi i këtyre marrëveshjeve nga ana e Kosovës do ta bënte më të lehtë zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 12 SHKURT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të hënën, me nderimet më të larta shtetërore, presidentin e Republikës së Sllovenisë, Borut Pahor. Pas ceremonisë shtetërore të dy presidentët mbajtën takim dhe përbashkët dhe më pas edhe takimin e përbashkët të të dyja delegacioneve, gjatë të cilit

Presidenti Pahor ka deklaruar se Sllovenia, si një prej vendeve anëtare të BE-së, vazhdimisht kërkon që pesë vendet anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat nuk e kanë njohur ende Kosovën, ta bëjnë një gjë të tillë së shpejti. Presidenti slloven ka folur edhe për faktorin ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Sllovenisë. Ai ka kërkuar të ketë një këmbim më të madh të bizneseve ndërmjet dy vendeve. "Sllovenia është



interesit të përbashkët, janë të shkëlqyera, janë strategjike. Po punojmë edhe me Serbinë që t'i implementojmë të gjitha marrëveshjet e arritura në Bruksel.

vendeve tona si parakushte për integritet evropian", ka thënë presidenti Thaçi, duke shtuar se Kosova do të vazhdojë të jetë pjesë aktive në luftën kundër terrorizmit. "Sfidat tona në të cilat do të përballlemi do t'i kalojmë bashkërisht në frymën evropiane. E kemi mirëpritur strategjinë e presidentit Juncker për vendet e Ballkanit Perëndimor. Natyrisht Kosova ka pritur pak më tepër qartësi, por

edhe Kosova do t'i kryejë obligimet e veta edhe sa i përket çështjes së demarkacionit në një kohë të shkurtër. Shpresoj në këtë drejtim dhe jemi duke punuar intensivisht. Gjithashtu, edhe sa i përket themelimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe", ka thënë Thaçi. Presidenti Pahor sot (e martë) do t'u drejtohet me një fjalim deputetëve të Kuvendit të Kosovës.



u vlerësua lart bashkëpunimin i ndërsjellë në mes të dy vendeve. Presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor, ka ftuar institucionet e Kosovës t'i respektojnë marrëveshjet ndërkombëtare me Serbinë dhe Malin e Zi. Në një konferencë të përbashkët për medie me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, presidenti slloven ka deklaruar se përbushja e obligimeve ndërkombëtare do ta ndihmonte Kosovën në rrugën e saj drejt integritet në BE. "Kosova duhet ta ratifikojë demarkacionin dhe t'i zbatojë marrëveshjet e arritura në Bruksel. Në këtë mënyrë zgjerimi i BE-së në Ballkanin Perëndimor do të ishte më i lehtë dhe i suksesshëm", ka thënë Pahori. Ai ka përmendur edhe samitin në Brdo-Brione, për të cilin ka theksuar se do të ndikojë në përmirësimin e raporteve ndërmjet vendeve të Ballkanit dhe integritet të tyre në BE.

investitore e rëndësishme në Kosovë, por përfshirja e këmbimit të bizneseve është e vogël. Mendoj se në muajin e ardhshëm Kosovën do ta vizitojë ministri i Jashtëm slloven me ekipin e afaristëve", është shprehur Pahori.

Kurse presidenti Hashim Thaçi i ka shprehur falënderim në emër të tij, të institucioneve të Kosovës dhe të popullit të Kosovës presidentit Pahor, për vizitën e tij që po i bën Republikës së Kosovës në prag të 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës. Presidenti Thaçi, duke vlerësuar lart raportet bilaterale në mes të Kosovës dhe Sllovenisë, ka thënë se ato kanë qenë dhe vazhdojnë të mbesin të shkëlqyera, duke u bërë ftesë investitorëve sllovenë të vijnë dhe të investojnë në Kosovë. Presidenti Thaçi është zotuar se Kosova do t'i përbushë obligimet ndërkombëtare që ka para vetes. "Mes Kosovës dhe Malit të Zi raportet tona janë të

Gjithashtu, edhe gjatë këtij viti synojmë ta arrijmë marrëveshjen tjetër historike, atë përfundimtare, që nënkupton normalizimin e plotë të marrëdhënieve dhe pajtimin mes dy


Thaçi: Për mua Bibël dhe Kuran është deklarata e pavarësisë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka hedhur poshtë çdo mundësi të ndarjes së Kosovës apo të shkëmbimit të territoreve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pas takimit me presidentin slloven, Thaçi ka thënë se debatet që janë iniciuar për këtë çështje janë vetëm spekulime. "Kosova ka integritetin e vet territorial të paprekshëm, është unik, i njohur dhe i pranuar ndërkombëtarisht. Janë shqetësuese debatet në prag të dhjetëvjetorit të pavarësisë për gjëra të kota dhe të tejkaluara. Këto deklarata për mua janë të vdekura. Ka pasur edhe më herët ide për ndarje dhe për shkëmbime territore", ka thënë Thaçi. Ai ka deklaruar se respektimi i integritetit territorial të Kosovës është crucial për të ardhmen e Kosovës, duke shtuar se për të Bibël dhe Kuran është deklarata e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.



Flet për "Epokën e re", Shkëlzen Maliqi

Vizita e kryeministrit malazez i kon



Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka vlerësuar se ardhja e kryeministrit të Malit të Zi, Dushko Markoviq, për vizitë në Kosovë, mund t'i kontribuojë zgjidhjes së çështjes së demarkacionit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se këto ditë edhe në koalicionin qeverisës ka pasur përpjekje që të tejkalohet ngërçi sa i përket çështjes së demarkacionit. Maliqi ka thënë se ka pasur kontakte edhe me Podgoricën që të gjendet një solucion që Qeverinë dhe Haradinajn e nxjerrin "faqebardhë". Ai ka uruar që vizita e kryeministrit malazez të jetë shenjë e kultivimit të marrëdhënieve më të mira fqinjësore. Sipas Maliqit, nëse Kosova do të këmbëngulë rreth "humbjes së territorit" nuk do t'i prishte marrëdhëniet vetëm me Malin e Zi, por edhe me një pjesë të madhe të bashkësisë ndërkombëtare

EPOKA E RE**Shqipëri HETEMI**

PRISHTINË, 12 SHKURT - Njohësi i proceseve politike në vend, Shkëlzen Maliqi, ka thënë se këto ditë në koalicionin qeverisës ka pasur përpjekje që të tejkalohet ngërçi sa i përket çështjes së demarkacionit me Malin e Zi. Ai ka pohuar se ka pasur edhe kontakte me Podgoricën që të gjendet një solucion që Qeverinë dhe Haradinajn e nxjerrin "faqebardhë". Në këtë kontekst, Maliqi ka shprehur optimizëm se vizita e paralajmëruar për të mërkurën në Kosovë e kryemi-

nistrit të Malit të Zi, Dushko Markoviq, mund t'i kontribuojë zgjidhjes së çështjes së demarkacionit. "Besoj se do të mund të kontribuojë sepse në ndërkohë edhe në koalicionin aktual qeverisës ka pasur përpjekje që të tejkalohet ngërçi dhe ka pasur edhe kontakte me Podgoricën që të gjendet një solucion që Qeverinë aktuale dhe Haradinajn e nxjerrin 'faqebardhë'. Vizita e kryeministrit Markoviq uroj të jetë shenjë e kultivimit të marrëdhënieve më të mira fqinjësore me Malin e Zi", ka deklaruar Maliqi në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re".

Ai ka vlerësuar se nëse Kosova do të këmbëngulë rreth "humbjes së territorit" nuk do t'i prishte marrëdhëniet vetëm me Malin e Zi, por edhe me një pjesë të madhe të bashkësisë ndërkombëtare, përkatësisht me vendet që kanë ndihmuar më së shumti pavarësimin dhe afirmimin e shtetit të Kosovës. "Nëse Kosova do të mbetet këmbëngulëse rreth 'humbjes së territorit' nuk do t'i prishte marrëdhëniet vetëm me Malin e Zi, por edhe me një pjesë bukur të madhe të bashkësisë ndërkombëtare, dhe pikërisht me vendet që kanë ndihmuar më së shumti pavarësimin dhe

afirmimin e shtetit të Kosovës. Uashingtoni dhe Brukseli tërë kohën kanë pohuar se kufiri është në rregull dhe e kanë ftuar Kuvendin e Kosovës ta ratifikojë marrëveshjen. Së fundi kemi shenja të këndelljes së liderëve kokëfortë jo vetëm rreth ratifikimit të demarkacionit, por edhe rreth Gjykatës Speciale, që edhe më shumë rrezikonte 'rebelimin' absurd të politikës së Kosovës ndaj tutorëve tanë perëndimorë", është shprehur Maliqi.

Maliqi në këtë intervistë ka folur edhe për 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës, me ç'rast ka thënë se vendi ynë sot është më i përparuar se në vitin 2008. Megjithatë, ai ka theksuar se ndërtimi dhe ngritja e Kosovës është proces kompleks. Pavarësisht prej lëshimeve dhe dobësive, Maliqi ka thënë se Kosova është storie suksesi dhe jo dështimi. "Në pikat e shkurtra, për dallim nga skepticizmi dhe vlerësimet edhe në opinionin tonë, se 'shteti i Kosovës është një dështim', që është slogan që e përsërisin si papagallët propagandistët e Rusisë, të Serbisë dhe të vendeve të tjera armike të Kosovës, unë mendoj se e

vërteta është më afër atij sloganit tjetër që vjen nga ShBA-ja, që thotë se 'Kosova është storie e suksesit!', ka deklaruar Maliqi.

"Epoka e re": Z. Maliqi, është paralajmëruar se të mërkurën Republikën e Kosovës do ta vizitojë kryeministri i Malit të Zi, Dushko Markoviq. Çfarë do të thotë kjo vizitë për shtetin e Kosovës, kur dihet se me Malin e Zi kemi një temë të papërfunduar?

Maliqi: Vizita e kryeministrit Markoviq uroj të jetë shenjë e kultivimit të marrëdhënieve më të mira fqinjësore me Malin e Zi. Tema e papërfunduar, siç e quajmë ju, është e tillë për neve kosovarët, sepse kemi konteste të brendshme rreth kufirit të Kosovës me Malin e Zi, se ku ka qenë ai më 31 dhjetor të vitit 1989. Në vitin 2015 Qeveria e Kosovës e ka nënshkruar marrëveshjen e demarkacionit, të cilën Kuvendi i Malit të Zi edhe e ka ratifikuar, kurse në Kosovë është ngritur pakica opozitare kundër kësaj marrëveshjeje, është bllokuar edhe vetë puna e Kuvendit me gaz lotsjellës, me pretekstin se 'Kosova me marrëveshjen humbet 8 mijë

tribuon zgjidhjes së demarkacionit



pion i kundërshtimit të demarkacionit, ndër aktet e para që ndërmoi ka qenë zëvendësimi i komisionit që pajtoi demarkacionin, me një komision që udhëhiqej nga kundërshtarët e marrëveshjes. Puna e këtij komisioni doli bluf dhe skandal, sepse më parë ata pohonin se i kanë të gjitha argumentet se Kosova ka humbur territor, ndërkaq pas raportit që dhanë, doli se ato pohime kanë qenë spekulime dhe nuk ofruan asnjë provë solide për 'humbjen e 8 mijë hektarëve'. Edhe Haradinaj në mbledhjen e Qeverisë bëri gafën e dërgimit të marrëveshjes në Kuvend për aprovim, ku raporti i komisionit të Bulliqit shërbente vetëm si informatë shtesë, e jo kontest valid i marrëveshjes. Pra, nga kjo po shihet se ne nuk kemi problem me Malin e Zi, por kemi problem të brendshëm.

"Epoka e re": Ardhja e kryeministrit malazez, a mund t'i kontribuojë zgjidhjes së çështjes së demarkacionit?

Maliqi: Besoj se do të mund të kontribuojë sepse, në ndërkohë, edhe në koalicionin aktual qeverisës ka pasur përpjekje që të tejkalohet ngërçi dhe ka pasur edhe kontakte me Podgoricën që të gjendet një solucion që Qeverinë aktuale dhe Haradinajn e nxjerrin 'faqebardhë'.

"Epoka e re": Këto ditë është prezantuar një ide, sipas së cilës, ky version i demarkacionit mund të kalojë në Kuvend, por paraprakisht do të

duhej nënshkruar një deklaratë nga të dyja palët, me anë të së cilës mund të rishikohet procesi i demarkacionit nëse në të ardhmen gjendet ndonjë fakt i ri. Si e shihni një ide të tillë?

Maliqi: Një deklaratë e tillë mbase mund të nënshkruhet formalisht, për të krijuar mirëbesimin mes palëve, por edhe një adresë opinionit të atyre që mendojnë se marrëveshja është bërë me gabime. Por, ky kusht ekziston edhe në vetë marrëveshjen ku thuhet se 'shënimi i saktë i kufirit mes dy vendeve do të bëhet pas ratifikimeve në afatin dyvjeçar, ku mund të bëhen edhe korrigjimet në terren. Pra, po del se kemi bërë shumë zhurmë për asgjë, për diçka që është paraparë të bëhet edhe me vetë marrëveshjen e kontestuar.

"Epoka e re": A rrezikohet Kosova që t'i prishë raportet me Malin e Zi rreth kësaj çështje?

Maliqi: Nëse Kosova do të mbetet këmbëngulëse rreth 'humbjes së territorit' nuk do t'i prishte marrëdhëniet vetëm me Malin e Zi, por edhe me një pjesë bukur të madhe të bashkësisë ndërkombëtare, pikërisht me vendet që kanë ndihmuar më së shumti pavarësimin dhe afirmimin e shtetit të Kosovës. Ne kemi pasur një komision ndërkombëtar që ka vërtetuar se kufiri sipas marrëveshjes është në rregull, Kosova është në kufijtë e vet sipas Kushtetutës së vitit 1974 të ish-Jugosllavisë. Uashingtoni dhe Brukseli tërë kohën kanë

pohuar se kufiri është në rregull dhe e kanë ftuar Kuvendin e Kosovës që ta ratifikojë marrëveshjen. Së fundi kemi shenja të këndelljes së liderëve kokëfortë jo vetëm rreth ratifikimit të demarkacionit, por edhe rreth Gjykatës Speciale, që edhe më shumë rrezikonte 'rebelimin' absurd të politikës së Kosovës ndaj tutorëve tanë perëndimorë!

"Epoka e re": Z. Maliqi, çfarë vlerësimi keni për Kosovën në këta dhjetë vjet shtet? Cilat janë të arriturat, dështimet dhe sfidat e së ardhmes?

Maliqi: Në pikat e shkurtra, për dallim nga skepticizmi dhe vlerësimet edhe në opinionin tonë se 'shteti i Kosovës është një dështim', që është slogan që e përsërisin si papagallët propagandistët e Rosisë, të Serbisë dhe vendeve të tjera armike të Kosovës, unë mendoj se e vërteta është më afër atij slogani tjetër që vjen nga ShBA-ja, që thotë se 'Kosova është storie e suksesit'. Kur të përmblihen faktet relevante si numri i njohjeve të shtetit të Kosovës, proceset afirmative në shumë fusha të ndërtimit të sistemit, të mbarëvajtjes së proceseve zgjedhore, të krijimit të institucioneve, të rregullimit të ekonomisë, të shërbimeve publike, të përparimit në sport, kulturë, pastaj vendosja e kanaleve të ndryshme të komunikimit me botën etj. Kosova është sot shumë më e përparuar se në vitin 2008, kur e shpalli pavarësinë. Por, ndërtimi dhe ngritja e Kosovës është proces kompleks, ku kemi shumë

segmente të realitetit me ngecje dhe probleme të cilat atë faqen e ndritur të përparimit e tregojnë si tejet të ngrysur, me tendenca që shpijnë në katastrofë. Këto perceptime skajshmërisht të ndryshme, kur dikush numëron vetëm të mirat dhe tjetri shikon vetëm ngecjet. Dështimet ndonjëherë dominojnë diskursin publik dhe krijohet përshtypja e hendekut, e një konflikti që nuk është vetëm konceptual dhe ideologjik, por edhe diçka si polarizim luftarak i shoqërisë. Pikëpamja ime është se duhet të bëhet përpjekja për analizë sintetike, të merren parasysh të gjithë faktorët dhe stadet e zhvillimit të segmenteve të shoqërisë. Për shembull, së fundi kemi pasur shumë të shprehur krizën e drejtimit të shtetit dhe partive, që ka krijuar bindjen se lidhshipi aktual në spektrin e gjerë nuk është i përgjegjshëm, nuk punon për interesin e shtetit, por të klaneve dhe grupeve të interesit, se po e çon Kosovën drejt greminës etj. Ndërkaq që, paralelisht me zgjedhjet, ndonëse me ritme më të ngadalta, kemi vërejtur se votuesit kanë filluar ta ndëshkojnë këtë tip të lidhshipit dhe në zgjedhjet e ardhshme, do të mund të kemi një vetëdijësim më të madh ose edhe një përmbyse në skenën politike, që do ta sjellë brezin e ri të politikanëve më të dijshtëm dhe më ekspertë, në pozitat udhëheqëse. 10 vjet janë mbase pak për realizimin e shtetit funksional. Duhet të kemi më shumë durim dhe vlerësim kompetent të proceseve shoqërore dhe shtetformuese.

hektarë të territorit'. Qeveria e mëhershme e Isa Mustafës nuk arriti ta zgjidhë këtë problem, madje nuk e procedoi çështjen në Kuvend, kurse Qeveria e Haradinajt, i cili ka qenë kam-

Peterle kërkon vazhdimin e reformës elektorale në Kosovë

PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të hënën në takim shefin e misionit vëzhgues të Bashkimit Evropian për zgjedhjet në Kosovë, Alojz Peterle, i cili ia dorëzoi raportin për zgjedhjet në Kosovë. Presidenti Thaçi dhe shefi i misionit vëzhgues të BE-së, Alojz Peterle, janë pajtuar që zgjedhjet në Kosovë ishin të lira dhe demokratike, duke përmbushur standardet evropiane. Shefi i misionit vëzhgues të BE-së

për zgjedhjet në Kosovë, Alojz Peterle, ka kërkuar të vazhdohet reforma elektorale. Me këtë rast, presidenti Thaçi ka theksuar se brenda spektrit politik në Kosovë ekziston një gatishmëri për ta përfunduar reformën elektorale. Kjo reformë, sipas presidentit Thaçi, do ta forcojë edhe më shumë demokracinë në vend dhe do ta modernizojë sistemin elektor në Kosovë. Peterle është takuar edhe me kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka.



Berisha: FSK-ja e gatshme për t'u transformuar në Forca të Armatosura të Kosovës

"FSK-ja është në shërbim të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kemi shumë të arritura dhe presim shumë shpejt që të kalojmë në fazën tjetër në Forca të Armatosura të Kosovës. Kemi bashkëpunim të mirë me ndërkombëtarët dhe qysh tash jemi të gatshëm të kalojmë në fazën vijuese të transformimit", ka thënë ministri i FSK-së, Rustem Berisha

KLINË, 12 SHKURT (ER) - Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rustem Berisha, ka bërë me dije të hënën se FSK-ja është e gatshme të transformohet në Forca të Armatosura të Kosovës. "FSK-ja është në shërbim të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kemi shumë të arritura dhe presim shumë shpejt që të kalojmë në fazën tjetër, në Forca të Armatosura të Kosovës. Kemi bashkëpunim të mirë me ndërkombëtarët dhe qysh tash jemi të gatshëm të kalojmë në fazën vijuese të transformimit", ka thënë ministri Berisha gjatë

vizitës së tij në Komunën e Klinës, ku është pritur nga kryetari Zenun Elezaj.

Ministri Berisha është shprehur i gatshëm për ta ndihmuar Klinën në ndonjë projekt duke u bazuar në kapacitetet që ka FSK-ja. Në anën tjetër, kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, e ka njoftuar ministrin se qysh nga konstituimi i organeve komunale kanë filluar të punojnë për realizimin e kërkesave të qytetarëve. Ai ka pohuar se fokusi kryesor i qeverisjes lokale është siguria e ujit të pijshëm në zonat urbane dhe rurale, si dhe trajtimi i ujërave të zeza.



Lumezi kërkon nga prokurorët t'u japin prioritet lëndëve të korrupsionit



Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka kërkuar nga prokurorët e Ferizajt t'u japin prioritet lëndëve të korrupsionit dhe lëndëve të kontrabandimit me mallra dhe tregti të ndaluar

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

FERIZAJ, 12 SHKURT - Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka vizituar të hënën Prokurorinë Themelore të Ferizajt, ku ka analizuar punën e kësaj prokurorie së bashku me kryeprokurorin Shukri Jashari dhe prokurorët e kësaj prokurorie.

Kryeprokurori Lumezi ka përgëzuar të gjithë prokurorët e Prokurorisë së Ferizajt për efikasitetin që kanë treguar deri më tani, edhe pse me mungesë të prokurorëve dhe stafit mbështetës.

Prokuroria Themelore në Ferizaj gjatë vitit 2017 ka kryer 5 856 lëndë penale me persona të njohur, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura vetëm 509 raste. Lumezi ka kërkuar nga prokurorët e Ferizajt t'u japin prioritet lëndëve të korrupsionit dhe

lëndëve të kontrabandimit me mallra dhe tregti të ndaluar.

I pari i Prokurorisë së Shtetit ka kërkuar që prokuroria Themelore e Ferizajt ta ngrehë bashkëpunimin me institucionet e tjera, si Policinë e Kosovës, Doganat dhe Administratën Tatimore të Kosovës. Gjithashtu, Lumezi ka kërkuar që konfiskimi dhe sekuestrimi i mallrave të përfituara në mënyrë të kundërligjshme të ketë prioritet nga të gjithë prokurorët, si dhe ka kërkuar nga ta që çdo lëndë të përfaqësohet dhe të mbrohet me dinjitet në Gjykatë.

Ndërsa kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Ferizajt, Shukri Jashari, u shpreh se, pavarësisht prej efikasitetit të treguar deri më tani nga prokurorët e kësaj prokurorie, do të angazhohen edhe më shumë për t'i kryer të gjitha lëndët që i pranojnë në këtë prokurori.

UBT-ja nderon kontributin e ShBA-së dhe shoqatës 'Miqte e Amerikës'

PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - Për nder të 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, rektori i UBT-së, Edmond Hajrizi, ka ngritur të hënën flamurin e ri të ShBA-së afër shtatores së ish-presidentit Bill Clinton, për ta nderuar këtë aleat dhe mbështetës të fuqishëm të Kosovës në rrugën e lirisë e të pavarësisë, si dhe për të shprehur falënderim për partner-

in strategjik të UBT-së, Shoqatën "Miqte e Amerikës" në 14-vjetorin e themelimit të saj. Për ta treguar konsideratën e ndërsjellë për UBT-në, kryetari i kësaj shoqate, Agim Rexhepi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, i ka dhuruar emblemën e shoqatës rektorit Hajrizi, në shenjë falënderimi për mbështetjen

bashkëpunimin përgjatë këtyre viteve.

Hajrizi ka thënë se një dhuratë e tillë është shumë simbolike në krahasim me atë që ShBA-ja ka bërë për shtetin tonë. "ShBA-ja ka qenë vazhdimisht aleatja jonë më e fuqishme strategjike dhe këtë e ka dëshmuar përmes përkrahjes së ofruar në çdo proces të rëndësishëm nëpër të cilin

ka kaluar Kosova", ka deklaruar ai.

Me rastin e kësaj feste mbarëkombëtare, UBT-ja dhe rektori Hajrizi kanë vendosur të ndajnë dhurata modeste për mediumet informative, organizatat dhe personalitetet e shumta që kanë dhënë kontribut për realizimin e kauzës kombëtare për krijimin e shtetit të Kosovës.



'Loja' me simbolet shtetërore

PRISHTINË, 12 SHKURT - Simbolet e shtetit, himni, flamuri dhe stema, në rrethana normale, janë simbole që unifikojnë dhe mobilizojnë qytetarët e shtetit përkatës, por në Kosovë edhe pas 10 vjetësh të shpalljes së pavarësisë së saj, kjo nuk po ndodh, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve në vend.

Publicisti Milazim Krasniqi, profesor në Katedrën e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ka theksuar se lidhur me simbolet e shtetit të Kosovës ende ekziston një konfuzion, sikurse është konfuz edhe pozicioni ideologjik ndër shqiptarët e Kosovës. Sipas tij, qytetarët ende mbeten të ndarë në dy rryma, njëra që anon kah irredentizmi me iluzionin e bashkimit me Shqipërinë dhe rryma tjetër, ajo e pavarësisë të Kosovës. Rryma e parë, siç thotë profesor Krasniqi, është më agresive në retorikën dhe veprimet e veta dhe në një mënyrë e ka frikësuar rrymën tjetër. Sipas tij, elitat politike janë fajtorët kryesorë për, siç thotë ai, lojën me simbole. "Në kushte normale, simbolet, quhen simbole, por do të duhej të ishin mite. Pra, mit me të cilin mobilizohet shteti, qytetarët e një vendi. Kjo te ne nuk ka ndodhur. Them se faji kryesor është i konfuzionit ideologjik, i kalkulimit që bëjnë elitat politike dhe, pse jo, edhe i arsimit publik. Për gjithë këto



Vissar Kryazlu (AP)

vite arsimit publik nuk e ka një platformë të qartë se si duhet të afirmohen vlerat shtetërore dhe si duhet të bëhet identifikimi i qytetarëve me këtë shtet", ka thënë Krasniqi.

Sociologu Shems Krasniqi, profesor në Universitetin e Prishtinës, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se simbolet shtetërore të Kosovës, të cilat janë bërë të ditura me shpalljen e pavarësisë së vendit në vitin

2008, nuk janë pritur me ndonjë emocion të veçantë nga shqiptarët e Kosovës. Kjo për shkak se, sipas tij, për kohë të gjatë ata kanë pritur të identifikohen në masë të plotë me simbolet kombëtare. "Simbolet shtetërore në njëfarë mënyre kanë dalë pak si në befasi, sepse qytetarët shtetin e kanë pritur, pavarësinë e kanë pritur, por simbolet e tilla çfarë janë, nuk i kanë pritur. Nuk kanë pasur mundësi edhe

t'i paramendojnë, ndoshta se do të jenë asisoj dhe e kanë përjetuar, themi kushtimisht, si një lloj shoku, në momentin kur i kanë parë. Por, unë mendoj se tash, në një masë të madhe, qytetarët e Kosovës janë pajtuar me realitetin, të cilin e prezantojnë simbolet, sepse e kuptojnë që këto janë simbole shtetërore. Ndërsa simbolet kombëtare mbesin edhe më tutje, si simbole me të cilat identifikohen në

kuptimin kombëtar", ka thënë ai.

Çështja e simboleve shtetërore të Kosovës ka qenë temë debati dhe polemikash në opinion që para shpalljes së pavarësisë së vendit në vitin 2008, por edhe pas saj. Debatet dhe polemikat e tilla vazhdojnë edhe sot, madje edhe ndërmjet politikanëve që përfaqësojnë institucionet e shtetit në nivelin qendror dhe në nivelin lokal.

Japonezët do t'i identifikojnë ndotësit e ajrit në Prishtinë

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 12 SHKURT - Ekspertë japonezë, bashkë me ata vendorë, brenda këtij muaji do të nisin një hulumtim të mirëfilltë për identifikimin e ndotësve të ajrit në Prishtinë. Kështu janë marrë vesh të hënën ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj dhe përfaqësuesit e Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë (JICA). "Me këtë hulumtim do të kuptohet se kush në të vërtetë është ndotës më i madh i ajrit dhe në çfarë periudha kohore", ka thënë ministrja Reshitaj pas takimit me këta ekspertë.

Ministrja Reshitaj ka kërkuar që hulumtimi të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe të përbajë të dhëna të detajuara, në mënyrë që pastaj të jetë më i lehtë orientimi dhe fokusimi i masave për përmirësim të ndotjes së ajrit.



Eksperti për monitorimin e cilësisë së ajrit nga Japonia, Keiichi Takahashi, ka potencuar se aktualisht nuk ka të dhëna të sakta të ndotësve të ajrit në rajonin e Prishtinës. Në këtë takim është diskutuar edhe për bashkëpunimin ndërmjet JICA-s dhe MMPH-së si dhe për projektet të cilat i mbështet kjo agjenci.



Ndotja e ajrit, zgjidhjet më të mira përmes qytetarisë aktive

Komuna e Prishtinës po vazhdon aktivitetet konkrete në drejtim të uljes së nivelit të ndotjes së ajrit. Me propozim të një qytetareje, Komuna e Prishtinës ka njoftuar se ka vendosur kontaktet e para për blerjen e City Tree. "City Tree është biofiltrer që përmirëson dukshëm kualitetin e ajrit dhe efekti i tij është sa 275 drunjtë të mbjellë. Në një metër katror ofron hapësirë për 1 682 bimë, duke

e rritur kështu biodiversitetin në qytet. Është hapësirë e gjelbër që absorbon 250 gramë grimca të pluhurit në ditë dhe eliminon rreth 240 tonë CO2 në vit. Projekti me City Tree do të testohet gjatë vitit 2018, më pas do të shikohet mundësia që panele të tilla të vendosen në banesat ekzistuese", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës.

Ministri Gashi interesohet në ShBA për krijimin e bondeve për diasporën

PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, njëherësh ministër i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, në ditën e fundit të vizitës në ShBA, ka takuar drejtorin e programit për remitencat dhe migrim në Bankën Botërore, Dilip Ratha dhe Sonia Plaza, ekonomiste të lartë, me të cilët ka diskutuar rreth mundësive të bashkëpunimit në fushën e strukturimit të remitencave të diasporës dhe shndërrimit të tyre në një model të zhvillimit ekonomik dhe social. Ministri Gashi i ka informuar bashkëbiseduesit me projektet e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, posaçërisht ato që lidhen me investimet strategjike. "Ne kemi një diasporë të madhe të shpërndarë në

Evropë dhe ShBA dhe kontributi i kësaj diaspore në formën e remitencave është mbi një miliard euro në vit. Ne i shikojmë ata si partnerë të rëndësishëm, investitorë seriozë që mund t'i kanalizojnë këto remitencat drejt projekteve të rëndësishme në Kosovë", ka thënë Gashi. Zyrtarët e lartë të Bankës Botërore në anën tjetër e informuan ministrin Gashi për disa programe në të cilat janë duke punuar, në veçanti atë të krijimit të bondeve për diasporën, një model i cili është duke u aplikuar që nga viti 1951 në Izrael, ndërsa së fundmi ka filluar të aplikohet edhe në Nigeri. "Ne mund t'ju ndihmojmë duke ju ofruar ekspertizën tonë për krijimin e bondeve të tilla, regjistrimin e tyre, të kemi rol këshilldhënës", ka thënë Ratha.



KEK-u kthen në prodhim edhe 'Blokun A5' të Termocentralit 'Kosova A'



PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka kthyer në prodhim edhe "Blokun A5" të Termocentralit "Kosova A". Aktualisht Korporata është duke operuar me 100 për qind të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike sipas bilancit energjetik të aprovuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Ashtu siç është premtuar nga fillimi, edhe në takimet me kryeministrin e vendit, Ramush Haradinaj dhe zyrtarët e tjerë të institucioneve,

të gjitha parashikimet janë realizuar në një afat rekord pas arritjes së marrëveshjes dhe zhblokimit të procesit të zhvendosjes së banorëve nga zonat e Hadës dhe Shiptullës. Të gjithë punëtorët e KEK-ut, nga menaxhmenti, punëtorët e termocentraleve dhe ata të mihjeve, kanë punuar intensivisht që të arrihet një stabilitet maksimal dhe të kthehen në funksion të gjitha njësitë prodhuese para ditëve të festave të 10-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës", është

thënë në njoftimin e KEK-ut. Po ashtu, është bërë me dije se të gjitha njësitë gjeneruese në terren në mihje janë duke punuar me një intensitet të shtuar për t'i kompensuar rezervat e shpenzuara gjatë kohës sa kishte bllokadë si pasojë e vonesave në shpronësime. "Varësisht nga konsumi në vend dhe kërkesat nga operatorët në treg, KEK-u ka në dispozicion kapacitete prodhuese të energjisë deri në 780 MW/h", është thënë në njoftimin e KEK-ut.

Nënshkruhen kontratat e operatorëve për ndërtimin e autostradës Prishtinë - Gjilan

PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, në praninë e dy deputetëve të Kuvendit të Kosovës, që vijnë nga Gjilani, Zenun Pajaziti dhe Ahmet Isufi, ka nënshkruar të hënën kontratat e operatorëve ekonomikë për ndërtimin e autostradës Prishtinë - Gjilan. "Në pajtim me Ligjin për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, në praninë e dy deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që vijnë nga Gjilani, Zenun Pajaziti dhe Ahmet Isufi, bashkëpunëtorëve të mi dhe zyrtarëve të Ministrisë së Infrastrukturës, e këtij projekti shumë domethënës për Gjilanin", ka thënë ministri Lekaj. Ai ka shtu-



Gjilan. Kjo nënkupton se ne shumë shpejt do t'i fillojmë punimet për materializimin e këtij projekti shumë domethënës për Gjilanin", ka thënë ministri Lekaj. Ai ka shtu-

ar se nga çmimi fillestar për këtë projekt, buxhetit të Republikës së Kosovës i janë kursyer mbi 12 milionë euro, të holla këto që tashmë mund të alokohen për projekte të tjera.

ATK-ja mbylli 40 subjekte të lojërave të fatit

PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - Divizioni i Lojërave të Fatit, në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), gjatë javës së kaluar ka zhvilluar edhe një aksion në Komunën e Prishtinës, Prizrenit, Gjakovës, Gjilanit dhe Ferizajt, me qëllim të identifikimit të subjekteve të lojërave të fatit, të cilat jashtëligjshëm ushtrojnë këtë veprimtari. "Gjatë aksionit në fjalë inspektorët kanë vizituar 13 biznese të lojërave të fatit, tek të cilat janë konstatuar parregullsi të ndryshme sa i përket ushtrimit të kësaj veprimtarie. Gjithsej pesë subjekte janë mbyllur, pasi të njëjtat kanë vepruar pa licencë të ATK-së. Po

ashtu, janë lëshuar gjoba në vlerë 89 000 euro", është thënë në njoftimin e ATK-së. Sipas këtij njoftimi, vetëm gjatë muajit janar dhe shkurt të këtij viti ATK-ja ka mbyllur 40 subjekte të lojërave të fatit, të cilat njëkohësisht janë ndëshkuar me gjoba në vlerë 213 000 euro.



Zeka: Vendimet e marra për dhjetë vjet ishin më pak përfituese për prodhuesit



Politikat fiskale që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës e deri më sot ishin temë diskutimi në tryezën e organizuar të hënën nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK)

**EPOKA
ERE**

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 SHKURT - Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës (OEAK) ka organizuar të hënën një tryezë diskutimi me temën "Politikat fiskale në 10 vjet: mësimet për të ardhmen". Panelistë në këtë tryezë ishin ministri i Financave, Bedri Hamza, deputetët Mimoza Kusari-Lila dhe Avdullah Hoti, drejtori i Doganës, Bahri Berisha si dhe përfaqësues të bizneseve prodhuese. Me këtë rast, drejtori i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka folur për

zhvillimet ekonomike për këto dhjetë vjet të shtetësisë. "Nëse themi se gjatë këtyre 10 vjetëve çdo gjë ka qenë zi e terr, s'do ta themi të vërtetën. Vendimet e marra kanë qenë më pak përfituese për prodhuesit, pasi ata nuk i kanë marrë të gjitha përfitimet që kanë mundur t'i kenë", ka thënë Zeka.

Kurse ministri i Financave, Bedri Hamza, ka thënë se për të është nder të flasë për politikat fiskale. "Është nder të flasim për politikat fiskale në këtë dhjetëvjetor. Kosovën gjatë kësaj periudhe e ka karakterizuar një sistem tatimor me bazë të gjerë. Ne kemi shkuar

me ulje të tatimeve direkte. Pa një sistem bankar të qëndrueshëm është vështirë të flitet për zhvillim ekonomik. Çdoherë ka vend për reforma në ekonomi. Në këtë drejtim politikat fiskale janë një element i rëndësishëm", ka thënë Hamza. Ai ka shtuar se për tërheqjen e investitorëve nuk mjafton vetëm të thirrjet në politika fiskale, por ka nevojë për sundim të ligjit dhe siguri.

Ndërkaq deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se bizneset e Kosovës janë përballur me pabarazi qysh me nënshkrimin e CEFTA-s. "Nënshkrimi i CEFTA-s ka shkaktuar pasoja që ndihen edhe sot e asaj dite, për faktin se hymë me përfaqësim të UNMIK-ut. Ende prodhuesit kosovarë ballafaqohem me

disavantazhe prej 26 përqindësh më shumë të kostonë së prodhimit", ka thënë Kusari-Lila. Sipas saj, moskrijimi i zonave ekonomike është një shans i humbur për Kosovën përgjatë këtyre dhjetë vjetëve.

Edhe deputeti i LDK-së, ish-ministri i Financave, Avdullah Hoti, ka dhënë vërejtje të mosdiversifikimit të të hyrave dhe tek shpenzimet qeveritare. "Janë pesë apo gjashtë subjekte të mëdha që kontribuojnë në buxhetin e shtetit dhe kjo jep pasiguri në stabilitetin e të hyrave. Jemi munduar t'i diversifikojmë të hyrat që pjesa më e madhe të jetë nga të ardhurat personale, pra të paguajnë të gjithë dhe jo veç korporata. Gjithashtu, si sfida janë edhe reduktimi i shpenzimeve, investimet kapitale dhe rritja e shpenzimeve qeveritare të

ndikuara politikisht. Andaj, Qeveria mos të shpenzojë më shumë se 2 për qind të të hyrave", është shprehur Hoti.

Drejtori i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, ka thënë se në saje të reformave fiskale vetëm për muajin janar janë kursyer nga bizneset 4 milionë euro. Sipas tij, kjo ka të bëjë me stimulimin për bizneset dhe për zhvillimin ekonomik. Ai ka pranuar se në fillim të aplikimit të masave fiskale nga janari i këtij viti ka pasur paqartësi sa iu përket lirimeve doganore. "Zbatimi i masave fiskale ka filluar nga 1 janari. Fillimisht kemi pasur keqkuptime për lirimet e gjysmëprodukteve, por tani gjithçka është qartësuar dhe kemi marrë udhëzimet e qarta nga Ministria e Financave", ka pohuar Berisha.

Garantohet mbështetje financiare për Kompleksin Memorial të familjes Jashari



PRISHTINË, 12 SHKURT (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të hënën në takim drejtorin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, Idriz Blakaj, me të cilin ka biseduar për gjendjen e komplekseve memoriale në Kosovë, me theks të veçantë kompleksin memorial të familjes Jashari. Ministri Hamza i ka thënë drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, Idriz Blakaj, se përkrahja financiare për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e Kompleksit Memorial të familjes Jashari nuk do të mungojë asnjëherë. Ai ka

deklaruar se aktualisht janë në dispozicion një milion euro të cilat janë në shfrytëzim, kurse sa iu përket mjeteve shtesë, të cilat duhen për realizimin e projektit për kompleksin Adem Jashari, do të ndahen sipas kërkesës dhe nevojave që do të ketë kjo agjenci.

Ndërsa drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, Idriz Blakaj, ka falënderuar ministrin Hamza për gatishmërinë e tij për t'i mbuluar financiarisht shpenzimet sa i përket memorialeve në përgjithësi në Kosovë, në veçanti për Kompleksin Memorialin të familjes Jashari.

Flamuri i Kosovës sot vendoset 'Te rrethi'

Flamuri i Kosovës ishte vendosur te rrethi i spitalit nga Komuna e Prishtinës që udhëhoqej nga Isa Mustafa, por atë e kishin hequr aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje.

PRISHTINË, 12 SHKURT - Departamenti i Protokollit të Shtetit, i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme, sot (e martë) do ta vendosë flamurin e Kosovës "Te rrethi". Zyra për Informim e kësaj ministrie ka bërë me dije se flamuri i Kosovës do ta valojë përkrah atij kombëtar pasi të vendoset edhe një shtizë.

Flamuri i Kosovës ishte vendosur te rrethi i spitalit nga Komuna e Prishtinës që

udhëhoqej nga Isa Mustafa, por atë e kishin hequr aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje.

Kreu i Prishtinës, Shpend Ahmeti, këto ditë është përballur me presion publik për vendosjen e flamurit, por ai e kishte hequr përgjegjësinë nga vetja duke thënë se me një gjë të tillë duhet ta merret kryeministri. Ideja për vendosjen e flamurit të Kosovës 'Te rrethi' së pari u dha nga një grup i qytetarëve në rrjetin social "Facebook".



10-vjetori i pavarësisë, nis dekorimi i qytetit të Mitrovicës

MITROVICË, 12 SHKURT - Javën e kaluar, me vendim të Këshillit Organizativ, për dhjetëvjetorin e pavarësisë u vendos ikona e parë #Kosova10 në qendër të qytetit në afërsi të shtatorës së heroit kombëtar Isa Boletini, ndërsa ikona të tilla janë vendosur edhe në sheshet kryesore të dhjetë komunave të tjera. "Kjo ikonë është rreth 8

metra e gjatë, ndërsa është rreth 1.5 metra e lartë. Ajo përfaqëson hashtagun zyrtar të 10-vjetorit të pavarësisë. Të gjithë qytetarët mitrovicas kanë mundësinë që ikonën #Kosova10 ta përdorin në të gjitha postimet e tyre në rrjetet sociale", është bërë me dije në njoftimin e Komunes së Mitrovicës. Po ashtu, komuna

ka stolitur qytetin me flamuj të shtetit të Kosovës. "E gjithë festa do të shoqërohet me aktivitete të shumta të organizuara nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, por manifestime të ndryshme do të ketë edhe nga shkollat e komunës sonë", është thënë në njoftimin e Komunes së Mitrovicës.

Prishtina bën bashkë kryetarët e komunave shqiptare në rajon

PRISHTINË, 12 SHKURT - Këtë të premte kryetarët e Unionit të Komunave Shqiptare të Rajonit, Tiranës, Gostivarit, Ulqinit, Preshevës, Prizrenit dhe Tetovës, do të qëndrojnë për vizitë në Komunën e Prishtinës. Kjo pritje në Komunën e Prishtinës organizohet me rastin e 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, raporton "Klan Kosova". Temë diskutimi në këtë takim do të jetë ruajtja e ambientit dhe niveli i ndotjes së ajrit. Unioni i Bashkive dhe Komunave kryesore që drejtohen nga



shqiptarë në rajon është krijuar në nëntor të vitit 2016 me qëllim - krijimin e mekaniz-

mave të duhur të bashkëpunimit ndërmjet qyteteve shqiptare.

Në Prishtinë arrestohen dy persona për armë dhe drogë

PRISHTINË, 12 SHKURT - Në rrugën "Enver Maloku" në Prishtinë janë arrestuar dy të dyshuar pasi që gjatë kontrollit në automjetin e tyre është gjetur dhe konfiskuar një pistoletë me një

fishek dhe një sasi e substancës së dyshuar narkotike. Policia ka njoftuar se me vendim të prokurorit një nga të dyshuarit është dërguar në mbajtje, ndërsa tjetri është liruar.



Pagesa e faturave të mbeturinave bëhet në të gjitha pikat e Postës së Kosovës

PRISHTINË, 12 SHKURT - Kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka njoftuar se komuna të cilën ai e drejton ka filluar ta bëjë shpërndarjen e faturave për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka

shkruar se pagesa e këtyre faturave mund të bëhet në të gjitha pikat e Postës së Kosovës (pa provizion), në të gjitha bankat komerciale (edhe në formë elektronike përmes e-banking), si dhe në sportelet e Komunes së Prishtinës.



"MENDIME TË ZGJEDHURA PËR ADEM DEMAÇIN" (4)

ADEM DEMAÇI, UDHËRRËFYES I LIRISË



Selatin NOVOSELLA

56. Dardan Velija, kritik letrar: Adem Demaçi, rebeli i përjetshëm Jeta e Adem Demaçit përshkohet nga rebelimi i përjetshëm. Ai rebelohet kundër Jugosllavisë, kundër Serbisë, kundër Rugovës, kundër udhëheqësve të UÇK-së, në kohën e Rambujesë kundër tërë botës dhe kundër hakmarrjes ndaj serbëve pas '99-s. Në rastin kur sëmuret nga zemra ai rebelohet kundër vdekjes.

57. Daut Dauti, analist: Adem Demaçit iu bënë dy kërkesa nga udhëheqësi i OSBE-së, Daan Everst

Në pranverë të vitit 2000, udhëheqësi i atëhershëm i OSBE-së, Daan Everst, u takua me Adem Demaçin, që atëherë udhëhiqte shoqatën "Dardania". Në atë takim, shefi i OSBE-së kërkoi dy ndihma nga Demaçi. Ndihma e parë që kërkoi Everst ishte formimi i një komisioni për pajtim me serbët, që do të ishte i ngjashëm me atë që kishte ekzistuar në Republikën e Afrikës Jugore pas rënies së apartheidit. Kërkesë e dytë për ndihmë e Everstit ishte që Demaçi ta ndihmonte procesin e sapofilluar të organizimit të "zgjedhjeve të para dhe të lira në historinë e Kosovës".

58. Dilaver Goxhaj, ushtarak i Ushtrisë Shqiptare: Adem Demaçi e sugjeronte luftën guerile për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Hapin e parë që bëri Adem Demaçi, porsa pranoi detyrën politike të ofruar nga Shtabi Përgjithshëm, i sugjeroi këtij organizimi të lartë drejtues që ta ndryshonte strategjinë ushtarake të UÇK-së, "nga lufta për territor, ku pësoi disfatë, por jo edhe humbje përfundimtare, dhe të kalohej në metodën e luftës guerile".

59. Dmitrij Sedov: Adem Demaçi, një nga figurat më të njohura të separatizmit kosovar

Një nga figurat më të njohura të separatizmit kosovar është Adem Demaçi, i cili sot ka 77 vjet dhe është një personalitet kompleks i cili ka merita për shumë ngjarje të kohëve të fundit të Ballkanit.

60. Driton Sejdiu, gazetar: Adem Demaçi, simbol i qëndresës shqiptare në ish-Jugosllavi Adem Demaçi është simbol i qëndresës shqiptare në ish-Jugosllavi. Është i burgosur disa herë për veprimtarinë e tij politike, të cilat ishin në kundërshtim me sistemin shtetëror jugosllav dhe të cilat kishin për aspiratë bashkimin kombëtar.

61. Ekrem Kryeziu, regjisor: Adem Demaçi, artikullues i ëndrrave të shqiptarëve

Duke mos arritur të bëhemi si

Adem Demaçi, jemi munduar që atë ta bëjmë si veten tonë dhe, në këtë mënyrë, e kemi vrarë një pjesë të ndritshme të jetës sonë, e kemi vrarë ëndrrën.

62. Emin Hetemi: Jam fascinuar nga pikëpamjet filozofike të Adem Demaçit

Rastësisht kam hasur në betimin më të ri të romanit "Gjarpinjtë e gjakut" të Adem Demaçit, botoi LUMI, Lubjanë 1990. Jam tepër i fascinuar dhe i impresionuar me pikëpamjet filozofike të autorit, atëbotë një të riu, ndërsa tani të një të burgosuri politik me një kohëzgjatje po aq sa edhe vetë jeta ime.

63. Emin Kabashi, punëtor shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës: Adem Demaçi, mendësi e luftës për liri

Adem Demaçi asnjëherë nuk kishte qenë burrë shteti, në radhë të parë se nuk kishte shtet. Asnjëherë nuk kishte qenë njeri i politikës së ditës, por Adem Demaçi kishte marrë udhëheqjen e politikës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sepse ishte mendësi e luftës për liri kombëtare, andaj kur e thirri lufta për liri, ai ishte aty.

64. Emin Krasniqi, veprimtar i daluar i çështjes kombëtare: Metush Krasniqi dhe Adem Demaçi bënë thirrjet kushtrimtare

Sprova e përgjithshme, thirrjet kushtrimtare: "luftë deri në vdekje për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e saj me Shqipërinë Nanë", u bë në vitet e pesëdhjeta dhe gjashtëdhjeta të shekullit XX, nga dy drejtuesit e dy organizatave politike-atdhetare: nga Organizata "Partia Revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare me Shtetin Amë", në vitin 1957, që udhëhiqej nga Metush Krasniqi dhe nga organizata "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", në vitin 1964, që udhëhiqej nga Adem Demaçi.

65. Emrush Xhemajli, kryetar i Lëvizjes Popullore të Kosovës: Adem Demaçi, shembull i figurës çlirimtare

Në Lëvizjen Popullore të Kosovës Adem Demaçi ka qenë i pranishëm si shembull i figurës çlirimtare, si ide, si frymë dhe sidomos si personalitet i kthesave revolucionare.

66. Enver Hoxha, sekretar i parë i Parisë së Punës së Shqipërisë: Adem Demaçi dhe populli shqiptar në Jugosllavi kurrë nuk do t'i nënshtrohen zgjedhës jugosllave Në burgjet e Jugosllavisë vuajnë persekutimet më të egra shkrimtari patriot kosovar, Adem Demaçi dhe qindra të tjerë, të cilët, bashkë me popullin shqiptar, nuk i janë nënshtrohet dhe nuk do t'i nënshtrohen kurrë zgjedhës Jugosllave.

67. Enver Hoxhaj, ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Qeverinë e Kosovës: Adem Demaçi ka kaluar masën e njeriut të zakonshëm Baca Adem Demaçi ka kaluar masën e njeriut të zakonshëm, me përkushtimin dhe sakrificën e tij për popullin e Kosovës, me

përkushtimin e tij ndaj kombit të tij si dhe përkushtimin e tij ndaj njerëzimit dhe të drejtave të njeriut në tërësi.

68. Enver Topalli, veprimtar i shquar i çështjes kombëtare: Takimi i parë me Adem Demaçin ishte takim me të adhuruarin tim Ditën e dytë pas lirimit nga burgu, më 2 shtator 1992, arriti edhe Adem Demaçi. Ishte kënaqësia dhe befasia më e madhe e imja, sepse nuk e prisja një vizitë të tillë. Kjo më ndodhi edhe për faktin se unë takohesha me njeriun që aq shumë e kisha adhuruar dhe kurrë s'kisha besuar se një ditë do të takoheshim dhe do të bisedoja me të sikur të njiheshim kaheër.

69. Erion Veliaj, kryebashkiak i Qytetit të Tiranës: Adem Demaçi pagoi çmim të lartë për lirinë e Kosovës

Duke i kujtuar vitet e tmerrshme të burgut 28-vjeçar, e kupton realisht se çfarë çmimi të lartë ka paguar patrioti Adem Demaçi për Kosovën dhe çështjen shqiptare. Unë kam pak më shumë se 28 vjet, por e di se 28 vite janë shumë, janë tmerrsisht shumë, kur krimi i vetëm që ke bërë është të ngresh zërin për të drejtat e popullit tënd dhe njerëzve të tu.

70. Ethem Çeku, historian: Adem Demaçi, mendje historike e shqiptarëve

Po t'i referohemi vetëm disa nenvete të Programit të organizatës "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", në vitin 1964, shihet se sa vizionar ishte Adem Demaçi si mendje historike, sa strateg ishte si drejtues i një organizate që përballej me një strukturë të fuqishme të Sigurimit Shtetëror jugosllav, UDB-në, dhe sa diplomat ishte në konceptimin dhe shpërndarjen e pikëpamjeve të tija politike në arenën ndërkombe-tare.

71. Fadil Grajçevci, punëtor Shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës: Adem Demaçi i mungonte libri në gjuhën shqipe

Adem Demaçi, i rritur me mungesë të librave në gjuhën shqipe, numrat e revistës letrare "Jeta e Re", vetëm me disa dhjetëra faqe letërsi në gjuhën shqipe, nuk mund t'ia shuanin kureshtjen e madhe për njohjen e shpirtit të popullit të vet përmes letërsisë. 72. Fahrudin Radonçiq, publicist: Paraqitja e Adem Demaçit ka qenë e domosdoshme të një

Cili dhe çfarë konteksti politik

kushtëzoi paraqitjen e Adem Demaçit?! Duke shikuar volumin e gjenezës së komplikuar historike të Shqiptarëve në Kosovë dhe gjenezën e marrëdhënieve shqiptaro-serbe në këtë shekull, për herë e më tepër po bindemi se deri tek paraqitja e Adem Demaçit njëherë ka qenë e domosdoshme të vije.

73. Faik Mustafa, njëri prej organizatorëve të demonstratave të vitit 1968 në Tetovë: Adem Demaçi, metaforë lirie

Në të gjitha fitoret e shqiptarëve të Maqedonisë ishte i pranishëm edhe Adem Demaçi duke u shndërruar, për ditë e më tepër, në metaforë lirie. Fryma çlirimtare, mobilizuese, vigjilente dhe largpamëse e Adem Demaçit duhej të ishte edhe më tutje në mendjen e çdo politikani që, sot ose nesër, vendos për fatin e shqiptarëve, jo vetëm atyre të Kosovës, por edhe të Maqedonisë dhe më gjerë.

74. Faik Shkodra, shkrimtar: Adem Demaçi, figurë sublimë e lirisë së Kosovës

Pasioni, përkushtimi, organizimi, guximi dhe mbi të gjitha dija dhe horizonti i gjerë në njohjen e çështjes kombëtare mbeten dhuntitë që Adem Demaçin jo vetëm e stolisin, por e bëjnë ndërgjegje e figurë sublimë të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës.

75. Fatmir Arifi, veprimtar i çështjes kombëtare: Për Adem Demaçin, bashkimi i të majtës dhe të djathtës, është thelbi i filozofisë politike të tij

Amalgama ideologjike që synoi Adem Demaçi të krijojë dhe që në fund ia arriti duke bashkuar dy botëkuptimet ideologjike shqiptare: botëkuptimin e majtë dhe botëkuptimin e djathtë, është thelbi i filozofisë politike demaçiane.

76. Fatmir Limaj, ministër në Qeverinë e Republikës së Kosovës: Adem Demaçi, udhërrëfyes i lirisë

Adem Demaçi ka qenë dhe vazhdon të jetë sinonim i rrugës së lirisë, jo vetëm tek shqiptarët. Ai është njeriu i cili, qysh herët, me kohë, e ka parë që krijesa në të cilën kanë jetuar popujt e ish-Jugosllavisë ka qenë krijesë artificiale, e cila nuk mund t'i plotësonte as minimumin e kërkesave të popujve që e përbënin atë.

77. Faton Abdullahu, redaktor i gazetës "Prishtina Post": Adem Demaçi më ekspresiv se sa Nelson Mendela

Adem Demaçi, tri herë i dënuar

nga pushteti jugosllav, me gjithëse 35 vite burgim, nga të cilat i vuan 28 vite, na del në një mënyrë më ekspresiv sesa Nelson Mendela i cili është dënuar njëherë me burg të përjetshëm dhe nuk është liruar për 28 vite. Kjo do të thotë se sa herë ka dalë nga burgu Adem Demaçi, ka vazhduar veprimtarinë me konsekuencë të njëjtë, apo së paku është parë si i rezikshëm dhe prapë është dënuar, dhe kur është liruar, prapë, e ka vazhduar veprimtarinë politike.

78. Faton Topalli, veprimtar i çështjes kombëtare: Monografia "Pse dergjet në burg Adem Demaçi", libri i parë i kësaj natyre. Në kuadër të aktivitetit të vet të gjithanshëm politiko-patriotik, Komitetit i Kosovës për Informimin e Opinioneve Botërorë këto ditë e botoi librin "Pse dergjet në burg Adem Demaçi" i cili është shkruar nga publicisti militant dhe veprimtari i palodhshëm Xhafer Shatri.

79. Fazli Hajrizi, shkrimtar: Mendimi ndryshe i Adem Demaçit, ishte tipar thelbësor i intelektualit të mirëfilltë

Sipas regjimit komunist jugosllav botëkuptimet e intelektualëve shqiptarë, duhej të ishin në harmoni me ato të shtetit, duhej të ishin zëdhënës mjermanë të ideologjisë së pushtuesit të shqiptarëve. Adem Demaçi mendonte ndryshe dhe ky është tipar thelbësor i intelektualit të mirëfilltë.

80. Fazli Gajraku, drejtor i Bibliotekës Kombëtare "Pjetër Bogdani" në Prishtinë: Jeta dhe Vepra e Adem Demaçit do të jenë ndër më të kërkuar

Nga vitet e '50-të deri në vitet '90-të, për shkrimtarin dhe veprimtarin Adem Demaçi ishte një jetë e mundimshme dhe e kreshpëruar e vuajtjeve dhe mundimeve, dhe, për këtë, Jeta dhe Vepra e tij, e vërteta për të, do të jetë ndër më të kërkuar për lexuesit e tashëm dhe të ardhshëm të Kosovës.

81. Fehmi Baftiu, sekretar në Zyrën e Përfaqësuesit të Përgjithshëm Politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Demaçi: Adem Demaçin i tha Dinzbirit: "Siç jeni ndarë ju çekët dhe sllovakët edhe ne shqiptarët do ndahemi nga serbët!"

Më 23 janar 1999, erdhi Dinzbir thuaja i paparalajmëruar në Zyrën e Adem Demaçit. Shoqërohej nga një përkthyes shqiptar. Tha se ka ardhur për të bind Demaçin për të shkruar në bisedimet e Rambujesë me njerëzit që do t'i zgjedhë vetë. Gjatë bisedës, ai, papritmas, e quajti UÇK-në "terroriste dhe organizatë mafioze"! Pa kurrfarë kurtuzie protokolli, dhe me një nervozizëm të paparë, Demaçi iu drejtua përkthyesit: "Thuaj këtij... le të del jashtë!" Në të dalë, Dinzbir tha se për këto fjalë ka prova materiale, madje të shkruara nga vet shqiptarët, por Demaçi, me një zë të ngritur, arriti t'i thotë: "Siç jeni ndarë ju çekët dhe sllovakët, edhe ne shqiptarët do të ndahemi nga serbët!"

(Vijon)



A do të shfaqim emancipim institucional dhe kulturor për realizimin e kompleksit qeveritar, muzeut dhe obeliskut?

Me realizimin e këtyre tri projekteve, institucionet e Kosovës e kanë mundësinë ideale ta shfaqin zotimin që këto projekte publike do ta shprehin frymën demokratike të vendit tonë dhe do të jenë dëshmi vizuale e dinjitetit, krenarisë, energjisë, ndërmarrësisë, transparencës dhe stabilitetit të shoqërisë dhe të institucioneve të Kosovës. Kjo është realisht fryma me të cilën aleati ynë strategjik, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i qaset arkitekturës publike apo, siç e quajnë ata, arkitekturës federale. Në asnjë rast vendimmarrësit kosovarë nuk duhet t'ia lejojnë vetes luksin që të lëshohen në aventura të kopjimit primitiv të projekteve megalomane dhe arrogante presidenciale apo qeveritare, të ndërtuara në vendet e ish-Bashkimit Sovjetik



**Shkruan: Arianit
BYTYÇI, arkitekt**

Arkitektura është akt politik. Ndërtesat përfaqësojnë qëndrime politike. Arkitektura është gjithëherë e ndërlidhur me fuqinë dhe me interesat e mëdha, qofshin ato financiare apo politike. Arkitektura përdoret nga udhëheqësit politikë për të joshur, për të bërë përshtypje dhe për të frikësuar. Janë këto vetëm disa nga cilësimet që arkitektë dhe kritikë të nivelit botëror i japin për arkitekturën dhe raportin e saj me politikën.

Këto ditë në një nga takimet e Qeverisë së Kosovës, në prag të shënimit të dhjetëvjetorit të shpalljes së pavarësisë, mes të tjerash, u riafirmua ideja e ndërtimit të një kompleksi rezidencial të institucioneve shtetërore, siç u tha, "si domosdoshmëri e kohës dhe e prezantimit real të zhvillimit të Kosovës".

Në të njëjtën kohë, u prezantua edhe ideja e ndërtimit të Muzeut të Pavarësisë dhe Obeliskut të Lirisë. Duke vlerësuar rëndësinë e realizimit të këtyre projekteve, dua ta shpreh bindjen time se në të vërtetë ato duhet ta prezantojnë zhvillimin e aspiruar të shoqërisë dhe të shtetit tonë, e jo zhvillimin real që mbizotëron aktualisht tek ne. Dhe, për ta arritur këtë synim, arkitektura është instrumenti dhe mundësia më e mirë.

Pse e them arkitektura? Sepse arkitektura është akt i optimizimit, arkitektura ka të bëjë me shpresën, me ndryshimin. Kjo është thënë dhe është konfirmuar gjithmonë, decenie me radhë.

Në vendin tonë deri më tani projektet e ndërtesave apo komplekseve publike kryesisht janë trajtuar nga këndvështrimi rigjid teknik. Në shoqërinë kosovare edhe sot mbizotëron atmosfera ligjore, kulturore, ekonomike, ku ndërtimi nënkuptohet si proces tërësisht praktik dhe teknik. Fatkeqësisht, shoqëria dhe institucionet e Kosovës nuk e shohin ende ndërtimin si proces të krijimit të vlerave arkitektonike. Ky është një realitet që duhet ndryshuar, pikërisht përmes arkitekturës.

Të shprehim frymën demokratike të vendit tonë përmes arkitekturës bashkëkohore

Me realizimin e këtyre Kompleksit shtetëror, të muzeut dhe të obeliskut, institucionet e Kosovës e kanë mundësinë ideale që të shfaqin zotimin që këto projekte publike do të shprehin frymën demokratike të vendit tonë dhe do të jenë dëshmi vizuale e dinjitetit, krenarisë, energjisë, ndërmarrësisë, transparencës dhe stabilitetit të shoqërisë dhe të institucioneve të Kosovës. Kjo është realisht fryma me të cilën aleati ynë strategjik, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës i qaset arkitekturës publike, apo siç e quajnë ata arkitekturës federale.

Duke mishëruar këtë qasje

demokratike, të shprehur përmes shpalljes së konkurseve ndërkombëtare të arkitekturës për këto projekte, Qeveria e Kosovës duhet t'i kushtojë rëndësi parësore që objektivat dhe parimet udhëheqëse të këtyre konkurseve të arkitekturës të mishërojnë frymën bashkëkohore arkitektonike të Kosovës.

Në mënyrë të veçantë, për kompleksin rezidencial të institucioneve të Kosovës me seriozitetin më të lartë duhet të përgatitet një konkurs ndërkombëtar i arkitekturës, me detyrë projektuese të studiuar mirë, e cila shfaq objektiva të qarta të arkitekturës bashkëkohore. Natyrisht, edhe kriteret e vlerësimit duhet të përcaktohen bazuar në objektivat dhe përmbajtjen e detyrës projektuese dhe të peshohen në mënyrë meritore dhe transparente. Po ashtu, këshilltarët profesional që do të koordinonin tërë procesin dhe pastaj edhe juria që do ta bëjë vlerësimin e projekteve duhet të jenë emra kredibil dhe të mirënjohur botëror të arkitekturës së objekteve publike qeveritare. Dhe, emrat e tyre duhet të shfaqen në mënyrë transparente në publik, në mënyrë që kjo të ndikojë në kredibilitetin e konkursit ndërkombëtar që do të shpallej dhe në të njëjtën kohë në inkurajimin e pjesëmarrjes së arkitektëve nga mbarë globi. Kjo do t'i jepte vlerë konkursit dhe do ta bënte Kosovën një prej qendrave të promovimit të vlerave të arkitekturës bashkëkohore në botë.

Detyra projektuese për Kompleksin qeveritar në Prishtinën e Re duhet të japë përgjigje në dilemat se: Çfarë karakteri duhet të shfaqë projekti? Çka duhet të thotë ai për komunitetin? Çfarë funksione të mëdha organizative dhe funksionale duhet të përmbushë? Çka pritet nga struktura e objektit gjatë jetëgjatësisë? Si do t'i shërbejë institucioneve, shfrytëzuesve dhe komunitetit? Cilat janë veprimet aktive dhe pasive për mbrojtje nga zjarri, që duhet të ndërmerren? Çfarë lloj zgjerimi duhet të akomodohet, nëse ka nevojë në të ardhmen? A ekziston ndonjë sfidë e veçantë projektuese së cilës objekti duhet t'i përgjigjet? Çfarë kërkesa janë bërë në lidhje

me shfrytëzimin e energjisë, qarkullimin, marrëdhëniet publike-private, etj.? Me një fjalë, për çka shërben objekti? Si do t'i formësojë jetët e njerëzve që do të jetojnë apo punojnë në të?

Në literaturën bashkëkohore, autorë të ndryshëm evropianë, për objekte publike qeveritare specifikojnë edhe disa faktorë tjerë të veçantë dhe esenciale, që duhet të respektohen gjatë projektimit të këtyre objekteve, që përfshijnë trajtimin e këtyre çështjeve të rëndësishme:

Si e shfrytëzon qeveria arkitekturën për të prezantuar vetveten? Si i shfrytëzon ajo objektet për të prezantuar shërbimet e saj para qytetarëve? A duhet ky prezantim arkitektonik të jetë dominues, neutral ose i vetëdruajtur, kokëlartë, i rezervuar, perceptues ose miqësor, i inspiruar në vetëbesim ose i përkohshëm, kalimtar apo jetëshkurtër? Çfarë domethënie dhe çfarë metafora do të lejohen që objekti të shpreh këto karakteristika të ndryshme? Si do të ndërlidhet objekti me hapësirën publike? A do të kontribuojë në determinimin, aranzhimin dhe karakterin e hapësirës publike? A shpreh objekti publik një këndvështrim të caktuar të kulturës apo të shoqërisë? A krijon objekti një prezantim se si shoqëria funksionon ose se si duhet të funksionojë? A ka objekti kualitet të mjaftueshëm poetik ose a është mjaftueshëm inovativ për të shërbyer si një shembull i mirë?

Kompleksi qeveritar në Prishtinën e re të krijojë identitet origjinal dhe të vërtetë bashkëkohor të kulturës sonë

Nëse Qeveria e Kosovës synon që të realizojë një kompleks të mirëfilltë bashkëkohor qeveritar, i cili do të prezantonte frymën bashkëkohore dhe emancipuese që aspiron vendi ynë, atëherë konkursi ndërkombëtar i arkitekturës për këtë kompleks qeveritar duhet t'i trajtojë dhe në të njëjtën kohë të stimulojë krijuesit arkitektë nga e mbarë bota që të trajtojnë çështjet e lartpërmendura në mënyrë profesionale, me zgjidhjet e tyre kreative.

Arkitektura ka të bëjë me përmirësimin e kushteve: mjedisore, sociale dhe nganjëherë

edhe atyre politike, thotë Arjen Oosterman.

Përderisa, kritiku Paul Golderberger potencon faktin se arkitektura është përfaqësimi themelor fizik i një kulture, më shumë sesa madje edhe flamuri i saj. Shtëpia e Bardhë, Kapitoll Hilli, Piramidat, Kulla e Ajfelit, Porta e Brandenburgut, Shtëpia e Operës në Sidnej, Empire State Building, Golden Gate Bridge janë vetëm disa shembuj kuptimplotë që dëshmojnë rëndësinë e përfaqësimit të kulturës dhe identitetit të një shoqërie përmes arkitekturës.

Kompleksi qeveritar në Prishtinën e Re duhet të krijojë identitet origjinal dhe të vërtetë bashkëkohor të kulturës sonë dhe aspiratave tona emancipuese perëndimore. Në asnjë rast, vendimmarrësit kosovarë nuk duhet t'ia lejojnë vetes luksin që të joshen apo t'iu imponohet përzgjedhja e projektit në frymën e projektit maqedonas të ndërtesave dhe hapësirave publike "Shkupi 2014", një projekt tashmë i komprometuar arkitektonikisht dhe kulturalisht në arenën ndërkombëtare. Apo, të lëshohen në aventura të tjera të kopjimit primitiv të projekteve megalomane dhe arrogante presidenciale apo qeveritare, të ndërtuara në vendet e ish-Bashkimit Sovjetik.

Dhe, në fund, por jo më pak e rëndësishme: Kompleksi rezidencial i institucioneve të Kosovës dhe dy projektet tjera të proklamuar, muzeu dhe obelisku nuk duhet trajtuara me praktikën e tenderëve të shërbimeve të projektimit, ku kriter kryesor është çmimi më i lirë i ofertuesve, ashtu siç trajtohet edhe furnizimi me tonerë i një institucioni. Për Kompleksin Qeveritar, Ministria e Administratës Publike duhet të shpallë konkurs ndërkombëtar të arkitekturës të përgatitur me seriozitetin më të lartë, praktikë të cilën duhet ta zbatojë edhe Ministria e Kulturës për projektet e Muzeut të Pavarësisë dhe të Obeliskut të Lirisë.

Vetëm në këtë mënyrë mund të dëshmojmë emancipimin tonë institucional, kulturor dhe shoqëror për realizimin me sukses të këtyre projekteve madhore publike. Mbi të gjitha, arkitektura është emancipim. A do të kemi dije dhe guxim që ta arrijmë këtë, mbetet të shihet.

Shfletime historike: Personaliteti i Qazim Bajraktarit (1906-1947) (2)

Përkimet që ngjasojnë dhe flamuri i Bajraktarit në derë të shkollës

Enver S. MORINA

Grupet serbo-çetnike të udhëhequra nga kryeçetniku Drazha Mihajloviçi, të etura për zaptimin e trojeve shqiptare, filluan të organizojnë ofensiva të ashpra duke bërë spastrime e masakra ndaj popullit shqiptar, sidomos me fshatrat e banuara me shqiptarë përreth kufirit, si në Mal të Zi, Serbi, Kolazhin, Bihor, Rugovë, Çakor, Novi Pazar, Plavë e Gusi e shumë vise të tjera...

"Planet e Lëvizjes çetnike-serbe për një Serbi të Madhe hegjemoniste përfshiheshin nga Selaniku e deri në Arad dhe prej Tiranë e deri në Split" (Izber Hoti "Planet e lëvizjes çetnike serbe për shfarosjen e shqiptarëve (1941-1945)". Në një informatë të Komandës së Korpusit II Çetnik Kosovar dërguar Drazha Mihajloviçit shkruan se ky korpus është njësi hakmarrëse e Kosovës dhe sipas emrit, edhe sipas qëllimit dhe shpirtit kërkon luftë "deri në fund sa është emri kosovar [...] luftë e plotë kundër turqve e shqiptarëve në përgjithësi, luftë e pakompromis deri në shfarosje [...] (Izber Hoti "Planet e lëvizjes çetnike serbe për shfarosjen e shqiptarëve (1941-1945)".

Këtyre synimeve gjenocidale, atdhetarët shqiptarë i dolën përballë që më pushkë të mbrojnë të drejtën për të jetuar në tokën e tyre amtare. Në mesin e tyre ndër më heroikët ishte Qazim Bajraktari (1906-1947) që më mijëra bashkëluftëtarë t'i ndalojnë qëllimet shfarosëse në tokat shqiptare.

Në nëntor të vitit 1944 Qazim Bajraktari nuk u pajtua me qël-

limet e sllavo-komunistëve dhe më organizatën famëkeqe OZN-a (Odeljenje zaštite naroda) të cilët filluan ndjekjen e udhëheqësve të Ballit Kombëtar. Qazimi së bashku më vëllain Qerimin, pastaj me patriotët e kohës Ukë Sadikun, Marije Sllakun, Haki Sadriun, Ndue Perllëshin, Zef Gjiododën, Alush Smajlin, e të tjerë vazhduan veprimtarinë dhe luftën për liri.

Pas shpërndarjes së Brigadës së Shaban Polluzhës (në prill të vitit 1945) i cili u grupua në hapësira të tjera të Drenicës, nisnin formimet e luftëtarëve në Grykën e Garaçevës e cila arriti në mbi 3.000 vullnetarë nga të gjitha viset e Kosovës të udhëhequra nën drejtimin e profesor Ymer Berishës.

Në një tubim të madh prof. Ymer Berisha për shkak të kushteve të vështira të veprimtarisë këshilloj që grupet të shpërndahen më afër rretheve të tyre, të kontribuojnë në trevat prej nga vijnë. Forcat serbo-komuniste të udhëhequra nga OZN-a dhe brigadat e ardhura nga Serbia kishin shtuar frikën në komunat e banuara me shqiptarë.

Komandanti Qazim Bajraktari me vëllain Qerimin dhe Hoxhë Xajë Pataçanin, Nezir Senikun kontrollonin trevat nga Zatriqi e deri në malet e Berishës, Kleçkës. Është e njohur lufta e Senikut në prill 1945 në mes luftëtarëve vullnetarë shqiptarë dhe paramilitarëve



Qazim Bajraktari (1909-1947)

të OZNA-s. Lufta zgjati nga mesdita deri në mesnatë e cila përfundoj me kullën e djegur shkumb e hi, më 26 të vradë e dy eprorë (komandantë) e shumë të plagosur nga forcat armike ndërsa në shenjë hakmarrjeje brigadat serbo-çetnike vranë 20 njerëz të

pafajshëm, mysafirë a kalimtarë të rastit, torturuan me dhjetëra banorë të atyre anëve.

Qazimi i plagosur bashkë me bashkëluftëtarë të tjerë do të vazhdojnë luftën e tyre çlirimtare kundër forcave armike në treva të tjera si në malet e Lubotenit, Sharrit, Pashtrikut, Qakorrit, maleve të Drenicës, Kleçkës, Zatriqit e Jezercit. Në janar të vitit 1947 nga një sëmundje në bjeshkët e Jezercit vdes Qerimi, vëllai i Qazimit ku edhe varroset.

Siç ritregon njëri nga pasardhësit e Qazimit, arsimitari Xhavit Bajraktari, bazuar në shkrime dhe dokumentime, fundi i veprimtarisë së heroit Qazim Bajraktari ishte i papritur dhe në rrethana tradhtie: "Në shkurt të vitit 1947 bashkë më disa bashkëluftëtarë Qazimi kthehet në Grykën e Garaçevës të ftuar nga një "mik". Në fshatin Sferkë e Gashit i vënë kurthin e tradhtisë dhe të zënë në pritë nga forcat serbo-komuniste vriten Qazim Bajraktari, Halil Sadriu. Shpëton vetëm Ukë Sadiku i cili pas një viti pushkatohet nga regjimi jugosllavo-komunist, që si vegël kishte shumë shqipfolës e njëri ndër më të dalluarit, më të ashprit ishte prokurori i kohës Ali Shukriu..."

Në vitin 1994 Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës mban simpoziumin "Gjenocidi dhe aktet gjenocidale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga Kriza

Lindore e këndej (më vështrim të veçantë mbi burimet serbe të fakteve)" dhe në po atë vit përgatitet dhe botohet monografia "Qazim Bajraktari, prijës i Bajraktarit të Astrazubit" i autorit Jetish Kadishani, vepër kjo burimore dhe e rëndësishme për të rikujtuar njërin nga heronjtë kombëtar, vepër e cila është ribotuar e plotë në vitin 2001.

"Flamuri i Bajraktarit në derë të shkollës

Kur e pyeten bashkëfshatarin Murat Bajraktarin gjatë një ndeje në Astrazup:

-Baca Murat, ke bërë shumë vjet, po na intereson të dimë: kujt mendoni t'ia lini në dorë flamurin e Bajraktarit të Astrazupit?

Murati u përgjigj:

-Po, flamurin e Bajraktarit të Astrazupit ka herë e kam vënë mbi derë të shkollës në Astrazup. Kjo vatër arsimore do të nxjerrë gjenerata shkollarësh që do t'i shpijnë nga brezi në brez meritat e Bajraktarit të Astrazupit, ne atëherë me grykën e pushkës e këta sot me dritën e ditorisë!

Tregoi: Sahit Ilaz Bajraktari, Astrazup"

(Nxjerrë nga monografia "Qazim Bajraktari, prijës i Bajraktarit të Astrazubit" i autorit Jetish Kadishani)

Përkimet vazhdojnë të jenë edhe më sublimë: 71 vjet më parë, më 17 shkurt (1947), vritet Qazim Bajraktari. Në dhjetëvjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, në këtë jubile të rëndësishëm për popullin shqiptar në përgjithësi ndodhën heronjtë. Dhe vendin meritor duhet zënë edhe emri i Qazim Bajraktarit...

(*"Kalabria", Prishtinë, shkurt 2018. Fund*)

Kinemaja 'Jusuf Gërvalla' këtë javë shfaq filmat vendorë

Si pjesë e programit do të shfaqen edhe filmat vendorë si filmi "Shok", "Home", "Ballkoni", "Si qeni n'rrush", "t'Padashtun". Po ashtu, do të shfaqet premiera për herë të parë në Pejë e filmi "Martesa" nga Blerta Zeqiri.

PEJË, 12 SHKURT (ER) - Kinemaja "Jusuf Gërvalla" në Pejë ka shpalosur programin e filmave dhe aktiviteteve për këtë javë, të cilat do të fillojnë nga dita e enjte. Si pjesë e programit do të shfaqen edhe filmat vendorë si filmi "Shok", "Home", "Ballkoni", "Si qeni n'rrush", "t'Padashtun". Po ashtu, do të shfaqet premiera për herë të parë në Pejë e filmi "Martesa" nga Blerta Zeqiri. Gjithashtu, do të bëhet edhe shfaqja e pro-

gramit të filmave të shkurtër të animuar si pjesë e programit "Best of Anibar" ku do të shfaqen filmat më të mirë të festivalit.

Në kuadër të kësaj jave do të mbahet edhe një punëtori njëditorë e Akademisë së Animacionit Anibar dhe jazz koncerti i USAF Band: The Ambassadors. Të gjitha këto aktivitetet do të mbahen në bashkëpunim me Qendrën Kinematografike të Kosovës dhe Anibar.

Programi i kinemasë Jusuf Gërvalla

E enjte 15.02.2018	E premte 16.02.2018
<p>'Shok' nga Jamie Donoghue 'Home' nga Miro Raca 'Ballkoni' nga Lendita Zeqiri 'Si qeni n'rrush' nga Dritan Haxhori dhe Vll Çitaku</p>	<p>T'Padashtun nga Edon Rizvanolli</p>
E shtunë 17.02.2018	E dielë 18.02.2018
<p>Shfaqja e filmave të animuar, Best of Anibar MARTESA nga Blerta Zeqiri</p>	<p>Koncert Jazz USAF band</p>

KINO Jusuf Gërvalla

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BASLE - MAN CITY

GG3+

JUVENTUS - TOTTENHAM

GG3+

CHARLTON - BRADFORD

GG3+

Kosova feston pavarësinë edhe me sport

Në Sheshin "Zahir Pajaziti" është bërë hapja e Festivalit Olimpik PyeongChang 2018 dhe Panairit të Sportit 2018, kurse të pranishëm ishin nënpresidenti i KOK-ut, Memli Krasniqi, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe ministri i MKRS-së, Kujtim Gashi. Në këtë mënyrë Kosova po e feston 10-vjetorin e pavarësisë edhe me sport



sikurse Majlinda, Nora, Akili, Distria e Albin Tahiri. Urime 10 vjet pavarësi! Urime dhe suksese Albin Tahirit në Olimpiadë! Mos të harrojmë se këtu kemi një kampion (Aziz Salihu), që ka marrë pjesë tri herë në Olimpiadë", ka thënë Veseli. Ndërsa ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, me rastin e hapjes zyrtare të Festivalit Olimpik "PyeongChang 2018" dhe Panairit të Sportit 2018, ka shprehur kënaqësinë që shumë sportistë të Kosovës janë pjesë e rëndësishme e shumë garave ndërkombëtare, sidomos LOD PyeongChang 2018. "Në emër të MKRS konfirmoj mbështetjen e fuqishme, në të njëjtën kohë edhe për federatat dhe KOK-un për organizimet e shumta që po i bënë", ka thënë Gashi, duke mos harruar edhe Rregulloren për Kategorizimin e Sporteve, si një gjë shumë e mirë për avancimin e sportit.

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 12 SHKURT - Nënpresidenti i parë i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Memli Krasniqi, ka thënë se është shumë e rëndësishme se për herë të parë në Kosovë po organizohet Festivali Olimpik, i cili qytetarëve, fëmijëve dhe shkollarëve ua sjell sportet e popullarizuara dimërore: patinazhin, hokejin dhe kërlingun. Këto komente Krasniqi i bëri në hapjen zyrtare të Festivalit Olimpik PyeongChang 2018 dhe

Panairit të Sportit 2018, aktivitete këto që lidhen edhe me shënimin e 10-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës. "Në vigjilje të 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës ne po bëjmë diçka për herë të parë, ku po marrim pjesë edhe në LOD në PyeongChang, ku Albin Tahiri po e përfaqëson Kosovën me dinjitet. Për herë të parë po u bashkohemi shumë vendeve të tjera të botës me organizimin e këtij Festivali Olimpik, duke jua sjell sportet e popullarizuara dimërore, qytetarëve, fëmijëve dhe shkollarëve tanë që ta

provojnë patinazhin, hokejin dhe kërlingun. Ju bëj thirrje ju fëmijëve që, krahas mësimeve, të merreni sa më shumë me sport", ka thënë Krasniqi. Pjesëmarrës në hapjen e Festivalit Olimpik ishte edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. "U kënaqa shumë

në hapjen e Festivalit Olimpik në Prishtinë. Bashkë me dhjetëra fëmijë provuam patinazhin dhe sporte të tjera. Kosova është kampione në shumë sporte dhe ne duhet të investojmë edhe më tepër, në mënyrë që të kemi vajza dhe djem që arrijnë majat e suksesit

Alpinistët nga Kosova për pavarësi do ta 'pushtojnë' Kilimanxharon

PRISHTINË, 12 SHKURT - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, ka pritur drejtuesit e Shoqatës Bjeshkëtare-Alpiniste "Shkëmbi" të udhëhequr nga kryetari Mensur Gashi. Pesë anëtarë të kësaj shoqate, për nder të jubileut të 10-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, më 17 shkurt 2018, synojnë të pushtojnë Majën e Kilimanxharos, në Tanzani të Afrikës, konkretisht "Uhuru Peak" (Majën e Lirisë), në një lartësi mbidetare prej 5 895 metrash. Ky aktivitet i natyrës sportive e promovuese mbështetet nga MKRS-ja dhe



realizohet në kuadër të agjendës për shënimin e 10-vjetorit. Ministri Gashi me këtë rast u

informua për planet dhe detajet e kësaj ekspedite si dhe për aktivitetet e tjera që realizon

shoqata "Shkëmbi". Ministri njëherësh i uroi alpinistët kosovarë për këtë aktivitet ashtu që emri dhe simbolet e Kosovës në ditën më të shënuar të vendit, në 10-vjetorin e ditëlindjes së shtetit, të dërgohen në majën më të lartë të kontinentit të Afrikës. "Ekspedita e alpinistëve tanë për 'pushtimin' e Kilimanxharos është një aktivitet i rëndësishëm në kuadër të agjendës së ngjeshur që ka përgatitur shteti ynë për shënimin e 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Është një nder që shteti ynë të promovohet në Afrikë në këtë datë të shënuar", ka thënë ministri Gashi.

Prishtina ndeshjet si vendëse i zhvillon në Pejë

PRISHTINË, 12 SHKURT - Skuadra e Prishtinës ndeshjet zyrtare në sezonin pranveror do t'i zhvillojë në qytetin e Pejës, përkatësisht në stadiumin "Shahin Haxhiislami". Me këtë rast skuadra kryeqytetase e ka falënderuar kryetarin e Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri dhe kryesinë e Besës që në këto kohë të vështira po i hap dyert për skuadrën e Prishtinës. Në sezonin vjeshtor, Prishtina ndeshjet si vendëse i zhvilloi në stadiumin e Feronikelit në Drenas.

Rikthehet Liga e Kampionëve

TORINO, 12 SHKURT - Liga më e fortë në botë e futbollit, Liga e Kampionëve, rikthehet pas një pushimi disamujor. Dy ndeshjet e para në mesin e gjashtëmbëdhjetë më të mirëve zhvillohen sonte (e martë) nga ora 20:45. Bazeli i Taulant

Xhakës e pret skuadrën më të fortë për momentin në Angli, Manchester Cityn. Kjo e fundit llogaritet favorite absolute, kurse ndeshja tjetër zhvillohet në Torino në mes të Juventusit dhe Tottenham Hotspurit. Kjo përballje është mjaft intere-

sante, ku dy skuadrat janë në formë të mirë dhe synim e kanë ecjen tutje në Ligën e Kampionëve. Në ligat vendore të dyja këto skuadra arritën fitore ku Juventusit e mposhti Fiorentinën (0-2), kurse Tottenhami e gjunjëzoi Arsenalin (1-0).



Feronikeli përkujton ish-kapitenin dhe dëshmorin, Rexhep Rexhepi

DRENAS, 12 SHKURT - Rruga për liri e pavarësi ishte e gjatë dhe e mundimshme e për arritjen e tyre Kosova pagoi një çmim të lartë, humbjen e djemve e vajzave që luftuan me qëllimin e shenjtë, atë të dhurimit të lirisë për gjeneratat e reja. Ndër këta të rinj ishte dëshmorin Rexhep Rexhepi, i cili e

la dashurinë e tij të madhe, futbollin dhe fanellën e Feronikelit, për ta veshur uniformën ushtarake e për të dalë në fushëbetë, ku edhe u vra nga ushtria serbe. Emrin e tij e mban me plot krenari stadiumi i Feronikelit, e që sot, në 19-vjetorin e rënies heroike të tij, po duket më madhështor

